

Kush ndikohet nga rritja e pagës minimale në vitin 2026?




Përmbledhje ekzekutive

Më 31 tetor të vitit 2025, Qeveria në detyrë e Kosovës nxorri vendim për rritjen e pagës minimale në vitin 2026, fillimisht nga 350 euro në 425 euro bruto (+21%) në pjesën e parë të vitit, ndërkaq në rreth 500 euro bruto (+43%) në pjesën e dytë të vitit. Nga kjo rritje, bazuar në një llogaritje të përafërt me të dhënat e muajit mars 2025, nga punëtorët me orar të plotë do të ndikohen mbi 131 mijë punëtorë. Përveç tyre, ndikohen edhe punëtorët që punojnë me orar të pjesshëm. Moshë mesatare e punëtorëve që preken nga rritja e pagës minimale bruto është 37 vjeç. Ndërsa, sektorët që pritet të ndikohen më së shumti nga ky vendim përfshijnë industrinë e ushqimit dhe pijeve, tregtinë me pakicë si dyqanet dhe qendrat tregtare, ndërtimtarinë, si dhe shërbimet personale të tilla si sallonet e bukurisë apo shërbimet e ngjashme. Në total, kosto shitesë për paga në vitin 2026 e shkaktuar nga ky vendim, të cilën duhet ta mbulojnë bizneset, është mbi 85 milionë euro. Në raport me faturën e përgjithshme të pagave në ekonomi, kjo përfaqëson një rritje prej rreth 2%.

Hyrje

Nga viti 2011 deri në vitin 2023, paga minimale bruto në Kosovë mbeti e pandryshuar për një periudhë 12-vjeçare. Gjatë kësaj kohe, punëtorët nën moshën 35 vjeç merrnin 130 euro si pagë minimale bruto, ndërsa ata mbi 35 vjeç merrnin 170 euro. Ky dallim i bazuar në moshë u eliminua plotësisht në vitin 2023, kur paga minimale u unifikua në 264 euro bruto për të gjithë punëtorët. Që nga viti 2023, paga minimale ka shënuar një rritje të vazhdueshme. Në vitin 2024, ajo u rrit në 350 euro bruto. Më tej, sipas Vendimit Nr. 10/273 të Qeverisë së Kosovës (datë: 31.10.2025), për vitin 2026 parashikohen dy faza rritjeje të pagës minimale: gjatë periudhës janar-qershor paga minimale do të jetë 425 euro bruto, ndërsa nga korriku e tutje do të arrijë në 500 euro bruto.

Figura 1. Paga minimale në Kosovë




Pagat minimale në vendet tjera

Aktualisht, Kosova ka pagën minimale bruto më të ulët në rajon me vetëm 350€ në muaj. Ndërsa në krahasim me vendet evropiane, diferenca është shumë më e madhe: Luksemburgu (2,571€) ofron pagë minimale bruto mbi 7 herë më të lartë se Kosova, Gjermania (2,054€) afër 6 herë më të lartë, Portugalia (957€) pothuajse 3 herë më të lartë, Sllovakia (750€) më shumë se 2 herë më të lartë, dhe Hungaria (707€) rreth 2 herë më të lartë.

Sipas të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), paga mesatare bruto në vend është 763 euro, ndërsa paga mediane është 609 euro. Paga më e shpeshtë (moda) është 350 euro, që përkon edhe me pagën minimale aktuale bruto në vend.

Në Kosovë, paga minimale bruto (350 €) përfaqëson 57.4% të pagës mediane bruto (609 €). Kjo do të thotë se paga minimale është dukshëm më e ulët se paga e zakonshme në ekonomi. Krahasuar me vendet e tjera, ky raport është më i ulët se në Shqipëri (80%), Portugali (70.7%), Luksemburg (64.3%) dhe Bullgari (63.4%), por më i lartë se në Gjermani (53.8%), Sllovakia (53.1%) dhe Hungari (50.3%).

Figura 2. Pagat minimale bruto në Evropë dhe raporti i pagës minimale bruto me pagën mediane, 2024



*Së fundmi, Qeveria e Shqipërisë ka njoftuar se nga data 1 janar 2026 paga minimale bruto do të rritet në 500 euro.


Burimi: Eurostat

Kush ndikohet nga rritja e pagës minimale?

Sipas të dhënave të ATK-së të muajit mars¹ 2025, rreth 93 mijë punëtorë do të ndikohen nga vendimi i Qeverisë së Kosovës për rritjen e pagës minimale në 425€ bruto nga janari i vitit 2026. Kjo shifër përfaqëson 25% të të gjithë atyre që janë deklaruar si të punësuar me orar të plotë në ATK, përkatësisht një të katërtën e të punësuarve.

Faza e dytë, që nënkupton rritjen e pagës minimale në 500€ bruto nga korriku i vitit 2026, do të prekë një numër edhe më të madh punëtorësh. Kur merren parasysh edhe punëtorët që nga janari marrin paga mes 425€ dhe 500€, shohim se më shumë se një e treta e të gjithë të punësuarve me orar të plotë në Kosovë do të përfitojnë drejtpërdrejt nga kjo masë, konkretisht 131 mijë të punësuar, që përbën 36% të totalit të të punësuarve me orar të plotë.

Figura 3. Shpërndarja e pagave bruto në Kosovë, mars 2025



*Kalkulimi i pagës mesatare bruto dhe asaj mediane është i bazuar vetëm tek punëtorët me së paku pagë mujore në vlerën e pagës minimale aktuale (350 euro bruto).


Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)

¹ Muaji mars është zgjedhur për të llogaritur pagën e të punësuarve meqë konsiderohet muaj josezonal dhe ofron një përfaqësim më të saktë të të ardhurave të rregullta.


Mosha mesatare e punëtorëve që preken nga rritja e pagës minimale bruto është 37 vjeç në të dy fazat. Kjo tregon se përfituesit kryesorë janë të punësuarit e moshës së mesme, që pavarësisht përvojës në tregun e punës, ende marrin paga në nivele minimale.

Faza I - rritja e pagës minimale në 425€
(janar-qershor 2026) - 37.4 vjeç

Faza II - rritja e pagës minimale në 500€
(nga korriku 2026) - 37.1 vjeç



Sa i përket aspektit gjinor, vendimi i Qeverisë për rritjen graduale të pagës minimale bruto gjatë vitit 2026 do të ndikojë kryesisht burrat (pasi ata kanë pjesëmarrje më të lartë në tregun e punës me 60% në krahasim me gratë 40%). Burrat përbëjnë 59% të përfituesve në fazën e parë dhe 56% në fazën e dytë. Ndërsa gratë përfaqësojnë përkatësisht 41% dhe 44% të punëtorëve që do të përfitojnë nga ky vendim.



41%

59%

Faza I - rritja e pagës minimale bruto në 425€ (janar-qershor 2026)




44%

56%

Faza II - rritja e pagës minimale bruto në 500€ (nga korriku 2026)



Figura 4. Sektorët më të ndikuar nga rritja e pagës minimale bruto, sipas numrit të të punësuarve me orar të plotë



Sa është kosto e bizneseve nga paga minimale e re?

Nëse marrim parasysh vetëm punëtorët me orar të plotë që aktualisht paguhen me pagën minimale prej 350 euro bruto, rritja automatike e pagës së tyre në vitin 2026 do të kushtojë rreth 85.4 milionë euro, duke supozuar se numri i të punësuarve mbetet i njëjtë. Në gjysmën e parë të vitit, kur paga minimale të rritet në 425 euro, bizneset do të kenë një kosto shtesë prej rreth 34 milionë euro. Nga muaji korrik e tutje, me rritjen e pagës minimale në 500 euro, kostoja shtesë për bizneset do të arrijë në rreth 51.4 milionë euro. Shprehur si përqindje e faturës së përgjithshme të pagave në ekonomi, kjo përfaqëson një rritje prej rreth 2%.

Kosto e rritjes së pagave
minimale bruto në 425€


gjatë fazës së parë
(janar-qershor 2026)

34 milionë euro

Kosto e rritjes së pagave
minimale bruto në 500€

gjatë fazës së dytë
(nga korriku 2026)

51.4 milionë euro



85.4 milionë euro

Ndikimi i rritjes së pagës minimale në punësim

Në këtë raport janë analizuar po ashtu efektet e dy rritjeve të fundit të pagës minimale në Kosovë në punësim, rritjen në 264 euro në shtator 2023 dhe rritjen pasuese në 350 euro në tetor 2024. Në mungesë të anketave me matje të përditësuar në nivel individual, duke përdorur të dhëna administrative mujore nga ATK sipas komunës dhe sektorit dhe një model empirik të përshtatshëm për të matur efektin e politikave të këtij lloji, Difference-in-Differences (DiD)², kemi krahasuar ndryshimet në punësim dhe paga në sektorët më të ekspozuar ndaj pagës minimale me sektorët më pak të ekspozuar, para dhe pas secilës reformë.

Rezultatet nuk japin evidencë statistikore për efekte negative në punësim në sektorët e trajtuar (më të ndikuar) pas rritjes së pagës minimale në 264 euro. Edhe për rritjen e pagës minimale në 350 euro, ndonëse modeli jep efekt negativ më të theksuar si në punësimin e përgjithshëm dhe tek te rinjtë, nga aspekti statistikor, duke qenë se variabla që mat këtë ndikim nuk është statistikisht sinjifikante, përsëri rezultatet nuk japin evidencë të mjaftueshme për të hedhur poshtë supozimin se rritja e pagës kishte efekt në uljen e punësimit tek të rinjtë.

Gjetjet janë në përputhje me literaturën ndërkombëtare që sugjeron se rritjet e moderuara të pagës minimale nuk shkaktojnë domosdoshmërisht humbje të vendeve të punës, por që mund të rris pengesat për të rinjtë dhe ata me më pak shkathtësi për të hyrë në tregun e punës pasi që punëdhënësit bëhen më selektiv.³ Ndonëse, në Kosovë, elemente sikurse ai i emigrimit, për çka bizneset po përballen me nevojën për punonjës, mund ta neutralizojnë këtë si efekt.

² DiD: $y_{\{kst\}} = \alpha + \beta (Post_t \times Trajtuar_s) + \gamma_k + \delta_s + \mu_t + \varepsilon_{\{kst\}}$


ku $y_{\{kst\}}$ përfaqëson variablën e varur (punësim, $\ln(\text{punësim})$, paga mesatare, $\ln(\text{paga mesatare})$) në komunën k , sektorin s dhe muajin t . $Post_t$ është një indikator që merr vlerën 1 pas hyrjes në fuqi të reformës, ndërsa $Trajtuar_s$ identifikon sektorët më të ekspozuar ndaj pagës minimale. Koeficienti β kap efektin diferencial të reformës në sektorët e trajtuar krahasuar me sektorët e kontrollit. Të gjitha specifikimet përfshijnë efekte fikse për komunë (γ), sektor (δ), muaj dhe vit (μ), duke kontrolluar për heterogjenitetin e pandryshueshëm dhe trende të përbashkëta kohore. Gabimet standarde janë klasterizuar në nivel sektori.

³ Shih punimin e Card dhe Krueger (1994) për pagën minimale, etj.

Tabela 1. Ndikimi i rritjes së pagës minimale në punësim

	Rritja e pagës minimale në 264 euro		Rritja e pagës minimale në 350 euro	
	Variabla e varur në formë logaritmike		Variabla e varur në formë logaritmike	
	ln_punësimi	ln_punësimi 15-24	ln_punësimi	ln_punësimi 15-24
1.post2023#1.trajtuar	-0.055	0.024	1.post2024#1.trajtuar -0.13	-0.238
Devijimet standarde	0.108	0.153	0.12	0.143
Variablat sinjifikante: * $p < 0.10$ ** $p < 0.05$				

Pra, siç dallohet nga tabela dhe figura, vlerësimet e paraqitura shoqërohen me pasiguri të konsiderueshme statistikore, me intervale të gjera të besueshmërisë. Por, nëse nisemi nga fakti që ndikimi i rritjes së pagës minimale në të gjithë faturën e pagave në vend do të jetë rreth 2%, dhe nëse përdorim gjetjet e studimeve të ndryshme që një rritje prej 1% e pagës minimale shoqërohet mesatarisht me një ulje prej vetëm 0.13% deri në 0.15%⁴ të punësimit (own wage elasticity), atëherë mund të themi se ndikimi negativ në punësim i rritjes së pagës minimale mund të jetë rreth 0.3% apo 1200 persona, që nuk paraqet ndonjë shifër të lartë.



⁴ Shih punimin e Dupe dhe Zipperer mbi studimet rreth ndikimit të pagës minimale

- Paga minimale, si instrument i politikës publike, mbron punonjësit në sektorët ku pagat janë tejet të ulëta apo edhe më të ulëta sesa niveli i produktivitetit të tyre, ku punonjësit, për arsye të ndryshme, nuk kanë fuqi të mjaftueshme negociuese.
- Ngjashëm, me rritjen e ndjeshme të çmimeve të konsumit në Kosovë në vitet e fundit, pagat në sektorët që janë në nivelin e pagës së vjetër minimale nuk arrijnë ta ruajnë fuqinë blerëse. Megjithatë, rritja e pagës minimale, edhe pse synon përmirësimin e kushteve të jetesës për punëtorët, sjell me vete disa sfida të rëndësishme që duhet të merren parasysh.
- E gjithë barra financiare nga rritja e pagës minimale do të bartet nga sektori privat, gjë që mund të ndikojë në qëndrueshmërinë ekonomike të bizneseve të vogla dhe të mesme.
- Koha e marrjes së vendimit vetëm dy muaj para përfundimit të vitit, ka shkaktuar probleme për bizneset të cilat duhet t'i planifikojnë buxhetet operative për vitin në vijim.
- Shkalla e informalitetit mund të rritet nëse zbatimi i pagës së re nuk shoqërohet edhe me monitorimin e nevojshëm nga institucionet relevante sikurse Inspektorati i Punës dhe Administrata Tatimore e Kosovës.
- Një pagë minimale e lartë mund të rrisë barrierat e punësimit të të rinjve dhe personave me më pak shkathtësi.

Instituti GAP rekomandon që vendimet për rritjen e mëtejshme të pagës minimale të shoqërohen me analiza të thelluara të ndikimit ekonomik që bazohen në anketa të përditësuar në nivel individual. Kjo për të vlerësuar më saktë efektin në punësim, por edhe për të matur nëse dallohen ndryshime në cilësinë e kushteve të punës, rritjen e numrit të kontratave me orar të pjesshëm, ndikimin më të saktë të rritjes së pagës minimale në çmime, etj. Po ashtu, të zhvillohen konsultime të gjera me palët e interesit, veçanërisht me bizneset në sektorët që punësojnë më shumë punëtorë me pagë minimale.

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339

info@institutigap.org

Instituti GAP përkrahet nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



Sweden
Sverige



KCSF

FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION



**Rockefeller
Brothers Fund**

Philanthropy for an Interdependent World